

Baldakini katër shekullor i altarit në Manastirin Baçkovski shkëlqen me bukuri të re



Argjendari Milen Vodeničarski restauroi baldakinin e altarit të kishës kryesore të Manastirit Baçkovski “Fjetja e Shën Hyjlindëses” në afërsi të qytetit Asenovgrad. Bashkë me ekipin ai pastroi emalin, rivendosi copëzat që mungonin dhe lyri me flori baldakinin i cili është pothuajse katër shekujsh. Baldakini u punua në vitin 1632 nga disa mjeshtër nga qyteti Çirpovci dhe është më i vjetri i ruajtur tek ne. Ai u punua prej argjendi, bakri, bronzi me ornamente të lyera me flori, zbukurime filigrani me emal me ngjyra.